



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 597/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesat e Rrjetit Ballkanit të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe Bashkimi Demokratik (BD) Qendrës së Numërimit dhe e Rezultateve (QNR), Prishtinë për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, dhe manipulimit të votave, dhe vendosjes së posterave në afërsi të qendrave të votimit në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Rrjeti Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë: Anr.597/2013, Anr.598/2013, Anr.600/2013, Anr.601/2013, Anr.603/2013, Anr.604/2013, Anr.605/2013, Anr.606/2013, Anr.607/2013, Anr.609/2013 Anr.610/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr.597/2013, Anr.598/2013, Anr.600/2013, Anr.601/2013, Anr.603/2013, Anr.604/2013, Anr.605/2013 dhe Anr.606/2013, Anr.607/2013, Anr.609/2013, Anr.610/2013 nga Rrjeti i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, me të cilat pretendohet se kanë ndodhur parregullsi gjatë procesit të votimit, dhe manipulimit të votave, dhe vendosjes së posterave në afërsi të qendrave të votimit gjatë ditës së votimit, në Zgjedhjet lokale të 3 Nëntorit 2013.

- Në ankesën Anr.597/2013, pretendohet se kanë ndodhur parregullsi të evidentuara nga vëzhguesit e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), në Qendrën e Votimit QV 3010C në Junik. Në këtë qendër votuese në Shkollën Filllore e Mesme të Ulët “Edmond Hoxha“, monitoruesit e BIRN,

ka identifikuar praninë e këshilltarit komunal të subjektit AAK-së në Junik Zenel Kuçi. Monitoruesit e BIRN konsiderojnë se prania e kandidatit për Këshilltar Komunal Zenel Kuçi të qendra e votimit (me afër se 100 m), komunikimi i tij ka rreth shkollës dhe duke komunikuar vazhdimisht me votuesit. BIRN në ankesën e tyre ka theksuar se disa qytetar e kanë fotografuar kandidatin për asamble të komunës.

- Në ankesën Anr.598/2013, pretendohet se kanë ndodhur parregullsi të evidentuara nga vëzhguesit e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) , të çertifikuar nga KQZ. Aty kanë vërejtur që anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje Yll Hoxha ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një statusi. Ai përmes kësaj fotografie ka bërë fushatë të hapur dhe ky veprim bje ndesh me par.2 të nenit 36 të ligjit për zgjidhjet e përgjithshme.
- Në ankesën Anr.600/2013, pretendohet se ka ndodhur parregullsi në QV 0101X në fshatin Carrabreg të Komunës së Deçanit. Gjatë monitorimit në vendvotimin me nr.0101X/07D në Shkollën Fillore dhe Mesme të Ulët “Lidhja e Prizrenit”, BIRN kishte evidentuar tollovi dhe zvarritje të procesit të votimit në të cilën klasë edhe votohej me kusht. Deri te tollovia kishte ardhur për faktin se klasa funksiononte me 5(pesë) anëtar të këshillave të votimit ndërsa nga ora 14:00 deri në ora 14:30min BIRN kishte qëndruar në monitorim në klasë dhe kishte mungesë të anëtarëve të këshillave të votimit.
- Në ankesën Anr.601/2013, pretendohet se ka pasur parregullsi në Qendrën e votimit 0105C në fshatin Strelc Komuna e Deçanit, ku në shkollën fillore të mesme të ulët “ Bajram Curri”, monitoruesit e BIRN kanë evidentuar praninë e këshilltarit komunal të subjektit politik LDK-së në Deçan Albert Kurtula, ku kandidati në fjalë është parë fillimisht te dyert e oborrit të shkollës duke frekuentuar rreth qendrës dhe duke komunikuar vazhdimisht me votuesit, ku i njejt i kandidatë është futur në oborrin e shkollës dhe ka qëndruar 5-10 metra larg qendrës votuese.
- Në ankesën Anr.603/2013, pretendohet se ka pasur parregullsi të ndodhura dhe të evidentuara nga vëzhguesit BIRN-it që kanë monitoruar qendrën e votimit të vendosur në shkollën fillore të mesme “ Hamëz Jashari” në fshatin Xërxë të Komunës së Rahovecit. Në fotografitë e bashkangjitura mund të shihni se në afërsi të shkollës kanë qenë të vendosura material propagandues të subjektit politik koalicioni Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.
- Në ankesën Anr.604/2013, pretendohet se ka ndodhur parregullsi të evidentuara nga vëzhguesit e BIRN-it të vendosur në qendrën e votimit të vendosur në shkollën fillore të mesme “ Hamëz Jashari ” në fshatin Xërxë të komunë së Rahovecit, ku në afësi të shkollës kanë qenë të vendosuar material propagandues të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).
- Në ankesën Anr.605/2013, edhe në këtë ankesë pretendohet se ka parregullsi në Qendrën e votimit 2026/A që ndodhet në shkollën fillore “ Nazim Buduri”

në fshatin Hoqë e qytetit në Prizren, ku në afërsi të kësaj qendre të votimit janë vreytur poster zgjedhor të ngjitura në afërsi jo me larg se 20metra të kandidatit për kryetar të komunës së Prizrenit nga radhët e Bashkimit Demokratik Zafir Berisha dhe kandidatit për asamble komunale Shaip Buduri nga Partia Demokratike e Kosovës PDK, që të dy në afërsi të njëra tjetrës. Po ashtu një poster i madh i PDK-së , në të cilin ishte fotografia e kandidatit për kryetar komune Ramadan Muja, së bashku me liderin e Partisë Demokratike të Kosovës Hashim Thaqi i cili ishte ngjitur në murin e një lokali në afërsi të qendrës së njejtë 2026/A.

- Në ankesën Anr.606/2013, pretendohet parregullsi në afërsi të shkollës fillore të mesme “ Hamëz Jashari” , në fshatin Xërxë të komunës së Rahovecit. Ku në afërsi të kësaj shkolle kanë qenë të vendosura matrial propagandues të subjektit politik koalicioni Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.
- Në ankesën Anr.607/2013, në afërsi të qendrës së votimit 0103C, që ndodhet në fshatin Gramaqel të komunës së Deçanit. Ku në qendrën votuese në shkollën fillore dhe të mesme të Ulët “ Drita”, monitoruesit e BIRN-it kanë pranuar informatën se menaxheri i qendrës së votimit Ramë Kasumaj prej orës 12 deri në ora 12.30 min në këtë qendër ka qenë i pranishëm drejtori i Drejtoratit për Arsim Kulturë nga komuna e Deçanit Qazim Maloku.Ky në cilësinë e drejtorit e ka keqpërdorur detyrën zyrtare ka tentuar që një të afërmi të tij të i mundësohet votimi pa dokument identifikimi, vetëm me një kartelë të bankës. KKV e kanë penguar votimin e tillë dhe për rastin e ka njoftuar Menaxherin e Qendrës, policinë dhe Prokurorin e rastit.
- Në ankesën Anr. 609/2013, në afërsi të qendrës së votimit 2115B që ndodhet në fshatin Llaushë të komunës së Skenderajit. Gjatë punës së monitorimit të komisionerëve kemi vreytur se vëzhguesit e Partisë Demokratike të Kosovës Liridon Leci ka zënë vendin e Komisionerit Rilind Geci. Ku vëzhguesi Liridon Geci përveq që kishte zënë vendin e komisionerit Rilind Geci po ashtu ai e kryente punën e komisionerit pasi që kontrollonte emrat e votuesve në librin e votuesve.
- Në ankesën Anr. 610/2013, në qendrën e votimit 1103B që ndodhet në komunën e Mitrovicës. Kemi vreytur se kryesuesi i këtij vendvotimi Rexhep Hajdari nga PDK ka lejuar votim familjar.Votuesja Abide Kulludra me numër të letërnjoftimit 1004797635 është lejuar të ndihmohet nga bashkëshorti i saj Jahja Kulludra me numër të letërnjoftimit 1174826021, ndonëse nuk plotësonte asnjë nga kërkesat ligjore të parapara me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 89 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore nga ankesat e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), janë bërë shkeljet e theksuara të subjektive politike PDK-së, LVV-së, LDK-së, AAK -së BD-së, lidhur me ngjarjet e personave të cilët kanë qenë në afërsi të vendvotimeve, dhe posedimit të posterave nga rradhët e kandidatëve për kryetar komune dhe për anëtarë të asambleve komunale subjekteve përkatëse të cilat janë në kundërshtim LZP dhe rregullat zgjedhore. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që nga dëshmitë e ofruara janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar parregullsi nga vëzhguesit e subjektit të lartcekur, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 597/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*